



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë më 26 gusht 2019
Nr.ref.:RK 1416/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI15/18

Parashtrues

Fehmi Hasani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 118/2017, të 10 tetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fehmi Hasani, me vendbanim në Fushë-Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ahmet Gjinovci, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 118/2017], të 10 tetorit 2017, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac. nr. 3431/2014], të 13 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan [C. nr. 172/2012], të 2 qershorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 [E drejta për Zgjidhje Efektive] të KEDNJ-së dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 31 janar 2018, parashtruesi i kërkesës përmes avokatit të autorizuar E. A. e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 5 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 9 shkurt 2018, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 4 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë me të cilën njoftoi Gjykatën për adresën e tij të re dhe një vërtetim për tërheqjen e shkresave të lëndës së tij nga avokati E. A. që e përfaqësonte.
11. Më 18 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përsëri disa dokumente që tashmë i kishte dorëzuar në Gjykatë avokati i tij, përkatësisht pjesë të vendimeve gjyqësore në rastet e dy të punësuarve të tjerë (E. B. dhe B. S.).
12. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendim për zëvendësimin e gjyqtarit raportues Altay Suroy, dhe në vend të tij u caktua gjyqtari Nexhmi Rexhepi.
13. Më 10 shtator 2018, Gjykata dërgoi një shkresë tek parashtruesi duke i kërkuar sqarim se a e përfaqëson tutje avokati E. A. Gjykata gjithashtu kërkoi që revokimi të dorëzohet me shkrim pranë Gjykatës.
14. Më 13 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatë dokumentin me të cilin kishte revokuar autorizimin e avokatit E. A. dhe dorëzoi një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 220/2018, të 4 korrikut 2018 ku paditës ishte një i punësuar i Aeroportit Ndërkombëtar “Limak Kosova” sh. a. në Prishtinë.
15. Më 12 nëntor 2018, Gjykata dërgoi një shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan dhe kërkoi sqarim lidhur me statusin e rasteve të bashkëngjitura nga ana e parashtruesit të kërkesës.
16. Më 26 nëntor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, njoftoi Gjykatën se lëndët e kërkuara janë në procedurë të ankesës në Gjykatën e Apelit.
17. Më 30 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Radomir Laban (anëtarë).
18. Më 19 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dërgoi një shkresë, me të cilën e informoi Gjykatën se përfaqësuesi i tij është z. Ahmet Gjinovci, avokat.
19. Më 22 korrik 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në pozitën punëtor sigurimi, në Aeroportin Ndërkombëtar “Limak Kosova” sh. a. në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: punëdhënësi).

21. Më 3 maj 2012, Komisioni disiplinor i punëdhënësit, nxori Vendimin HR-2012-240/08.05.2012-PP (në tekstin e mëtejme: vendimi i punëdhënësit), me të cilin ia ndërpreu parashtruesit të kërkesës marrëdhënien e punës, me arsyetimin se kishte kryer shkelje të rënda të detyrave të punës, sepse më 22 prill 2012 ishte zënë duke fjetur gjatë orarit të punës nga ekipi i menaxhmentit të punëdhënësit. Marrëdhënia e punës iu ishte ndërprerë dhe disa të punësuarve të tjerë me arsyetimin se “kanë fjetur në vendin e punës gjatë orarit të rregullt të punës”.
22. Më 11 maj 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për rishqyrtim të vendimit të lartpërmendur, në shkallën e dytë të punëdhënësit dhe për kërkesën e tij nuk kishte marrë përgjigje.
23. Si rrjedhojë, në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan dhe kërkoi anulimin e vendimit të punëdhënësit si joligjor, si dhe kërkoi të kthehet në vendin e punës dhe t’i paguhet dëmshpërblimi për shkak të mosrealizimit të të ardhurave personale. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se vendimi i punëdhënësit është joligjor sepse (i) nuk është marrë nga organi kompetent; (ii) nuk është shënuar koha, vendi dhe mënyra se si janë shkelur detyrat e punës si dhe (iii) punëdhënësi duhej ta kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës 30 (tridhjetë) ditë përpara për ndërprerjen e kontratës së punës.
24. Më 2 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit C. nr. 172/2012, refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar se (i) Komisioni disiplinor i punëdhënësit ishte i formuar konform nenit 8.1 të Rregullores për procedurat disiplinore dhe ankesave të punëdhënësit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja për procedurat disiplinore); (ii) vendimi i punëdhënësit përmbante kohën, vendin dhe mënyrën e shkeljes disiplinore; dhe (iii) Komisioni ka gjetur se në veprimet e parashtruesit të kërkesës janë elementet e shkeljes së rëndë të detyrave të punës nga neni 4.1.2 të Rregullores për procedurat disiplinore. Në bazë të Rregullores në fjalë, është përcaktuar se për shkelje të rënda të detyrave të punës, punëtorit mund t’i shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjykata Themelore gjithashtu theksoi se janë respektuar dhe dispozitat e nenit 70.4 dhe 85 të Ligjit të Punës.
25. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 172/2012, duke supozuar shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, *inter alia* duke konsideruar se: (i) aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i paqartë; (ii) vendimi i punëdhënësit kishte të meta; (iii) Gjykata Themelore nuk ka autorizim për të bërë cilësimin juridiko-ligjor të shkeljes së detyrave në punë dhe (iv) parashtruesi do të duhej të njoftohej 30 (tridhjetë) ditë përpara për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
26. Më 13 shkurt 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës (në testin e mëtejme: Gjykata e Apelit), përmes Aktgjykimit Ac. nr. 3431/2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 172/2012, të 2 qershorit 2012. Në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

theksohet se Gjykata Themelore ka marrë aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm, sepse në të janë dhënë arsyet konkrete për faktet vendimtare. Gjykata e Apelit, gjithashtu kishte arsyetuar se Gjykata Themelore nuk ka bërë vërtetimin e përgjegjësive disiplinore sepse këtë e ka bërë vetë punëdhënësi. Gjykata e Apelit më tej, arsyetoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës bëhet edhe pa paralajmërim sipas nenit 85 të Ligjit të Punës, dhe nenit 5.3 të Kontratës së punës të lidhur mes parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit.

27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër dy vendimeve të instancave më të ulëta, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në kërkesën e tij për revizion, parashtruesi i kërkesës përsëriti pretendimet e tij si në ankesën pranë Gjykatës së Apelit.
28. Më 10 tetor 2017, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), me Aktgjykimin Rev. nr. 118/2017, e refuzoi si të pabazuar revizionin. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nënvizoi elementet vijuese: (i) lidhur me përbërjen e Komisionit disiplinor arsyetoi se ishte në pajtueshmëri me Rregulloren për procedurat disiplinore; (ii) vendimi i punëdhënësit kishte përshkruar mënyrën, vendin dhe kohën e kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) veprimet e parashtruesit paraqesin shkelje të rëndë të detyrave të punës, prandaj sipas nenit 4. 1. 2 të Rregullores për procedurë disiplinore, nenit 5 të Kontratës së punës si dhe nenit 70. 4 dhe nenit 85 të Ligjit të Punës së Kosovës, marrëdhënia e punës ishte ndërprerë pa paralajmërim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt të KEDNJ-së, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 [E drejta për Zgjidhje Efektive] të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së.
30. Parashtruesi i kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm thekson se *“[...] aktgjykimi ankimor [Aktgjykimi i Gjykatës Themelore] përmban shkelje qenësore nga dispozitat e nenit 182 al. 2 pika n e LPK-së [...] nuk përmban arsye për faktet vendimtare, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsye lidhur me mangësitë - të metat e [vendimit të Punëdhënësit] [...]”*.
31. Për më tepër, parashtruesi pohon se *“[...] konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike shprehet në faktin se gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje kontestuese me asnjë provë nuk e ka vërtetuar faktin se ndaj paditësit është zbatuar procedura disiplinore në mënyrë se si është paraparë me ligj, dispozitat e aktit të brendshëm të paditurës ose organi disiplinor [...]”*.
32. Parashtruesi më tej pretendon se Gjykata Themelore ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike sepse procedura disiplinore në rastin konkret nuk

është zbatuar nga organi kompetent, dhe se vlerësimi i shkeljeve të detyrave të punës nuk është vërtetuar nga komisioni i punëdhënësit.

33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se “gjykata nuk ka autorizim ligjor të bëjë cilësimin juridik ligjor të shkeljes së detyrave në punë”. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi më tej pohon se Gjykata Themelore ka autorizim vetëm të konstatojë se gjatë procedurës disiplinore a është vërtetuar shkelja disiplinore.
34. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Gjykata Themelore ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe ka bërë interpretim të gabuar të saj.
35. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pohon se ka ndodhur trajtim i pa-barabartë sepse dy punëtorëve të tjerë (B. S. dhe E. B.) iu është ndërprerë marrëdhënia e punës me pretekstin e njëjtë, përkatësisht se janë zënë duke fjetur në vendin e punës ndërsa gjykatat e rregullta i kanë kthyer rastet e tyre në rigjykim dhe pohon se atij i është bërë e padrejtë.
36. Më tej, parashtruesi pohon se “rastet e tyre (të B. S. dhe E. B.) janë kthyer prapë në rigjykim ndërsa mbetet vetëm rasti im që është refuzuar nga tri gjykatat, ku të gjitha këto raste ka qenë dashur të ceken nga përfaqësuesi im ligjor”. Parashtruesi pohon se avokati i tij, ndër të tjera, do duhej të kishte cekur në procedurat pranë gjykatave të rregullta “[...] disa gjëra siç është rasti i mos cekjes në ankesë apo në ndonjë procesverbal mos prezencën e dëshmitarëve (anëtarëve të menaxhmentit) në asnjë seancë në gjykatën themelore [...]”.
37. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata “ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [...] dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme”.

Dispozitat relevante juridike

LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS

Neni 70

Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit

[...]

4. Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t'i specifikojnë llojet e keqsjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura.

Neni 85

Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës

- 1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese:*
 - 1.1. vërejte me gojë;*
 - 1.2. vërejtje me shkrim;*

- 1.3. ulje në pozitë;
- 1.4. suspendim të përkohshëm;
- 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës.

2. Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.

3. Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

40. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet, nenit 47 [Kërkesa Individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe e ka dorëzuar kërkesën e tij në afatin kohor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

42. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, në lidhje me të drejtën në proces të rregullt dhe të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me KEDNJ dhe të drejtën e barazisë para ligjit e paraparë me DUDNJ.

44. Duke ju referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se ai ka dy kategori të pretendimeve kryesore: (i) është i pakënaqur me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta, në veçanti me aktgjykimin e Gjykatës Themelore për shkak se ai ankohet për mënyrën në të cilën është vërtetuar gjendja faktike dhe aplikuar e drejta materiale, dhe me këtë rast pretendon shkelje në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (ii) pohon se rastet e bashkëngjitura nga ai, përkatësisht të dy punëtorëve të tjerë (B. S. dhe E. B.), do të duhej të ishin përmendur nga avokati i tij dhe thekson se *“rastet e tyre janë kthyer prapë në rigjykim ndërsa mbetet vetëm rasti im që është refuzuar nga tri gjykatat”*, dhe kjo sipas parashtruesit në thelb ka rezultuar në shkeljen e të drejtës së tij në barazi para ligjit.

(i) *Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së*

45. Gjykata fillimisht konsideron se pretendimet e parashtruesit të përmendura në kërkesë ngrenë çështje të ligjshmërisë, të cilat bien në domenin dhe në prerogativën e gjykatave të rregullta. Për më tepër, në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kategorinë e parë të pretendimeve e përsëritë në mënyrë identike ashtu si në procedurat pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

46. Në këtë drejtim, Gjykata së pari përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimi dhe aplikimi i ligjeve është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” sepse kjo do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
47. Më tej, duke pasur parasysh pretendimin e parashtruesit se aktgjykimi i Gjykatës Themelore “*nuk përmban arsye për faktet vendimtare, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitë arsye lidhur me mangësitë - të metat e vendimit kontestues të paditurës [vendimit të punëdhënësit]*”, dhe se gjykatat e rregullta kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkëlur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
48. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kishin arsyetuar plotësisht vendimet e tyre.
49. Për më tepër, sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me (i) përbërjen e Komisionit disiplinor, (ii) vendimin e punëdhënësit dhe (iii) periudhën se kur është dashur të njoftohet parashtruesi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme, detajisht ka arsyetuar dhe në mënyrë specifike ka adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, ndër të tjera, kishte arsyetuar:
- “[...] gjatë vizitës së ekipit të menaxhmentit, paditësi është gjetur duke fjetur gjatë orarit të rregullt të punës dhe sipas kësaj del se me këtë vendim [Vendimin e Punëdhënësit] janë përshkruar detajisht mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës disiplinore [...] nga procesverbali i takimit të komisionit disiplinor vërtetohet se kanë qenë prezent anëtarët e komisionit [...] kjo përbërje e komisionit është e përcaktuar me nenin 8.1 të Rregullores për procedurat disiplinore [...].
[...] Veprimet e paditësit paraqesin shkelje të rëndë të detyrave të punës nga neni 4.1.2 të Rregullores për procedurë disiplinore [...] dhe nenit 5 të Kontratës së Punës si dhe nenit 70.4 dhe nenit 85 të Ligjit të Punës së Kosovës [...].”*
50. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës obligojnë gjykatat që të argumentojnë arsyet për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të detajuar për çdo

argument të parashtruesit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61). Shkalla në të cilën Gjykata do të përmbushë obligimin për t'i argumentuar arsyet mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Atëherë gjithashtu duhet të merret parasysh, *inter alia*, se shumëllojshmëria e parashtrësive të paraqitura nga palët në procedurë mund të rezultojë me atë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme juridike gjatë hartimit të aktgjykimeve. Prandaj, çështja nëse gjykata e ka përmbushur obligimin për të argumentuar arsyet për vendimin e saj, i cili rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.

51. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe Gjykatën Supreme ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, gjë që do të kishte rezultuar me shkeljen e kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose të nenit 6 të KEDNJ-së.
 - (ii) *Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, dhe shkeljes së neneve 21 e 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, dhe nenin 7 të DUDNJ-së*
52. Më tej, sa i përket kategorisë së dytë të pretendimeve të parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi në thelb pretendon se e drejta e tij për barazi para ligjit siç garantohet me nenin 24 të Kushtetutës, është shkelur sepse parashtruesi pranë Gjykatës ka njoftuar se “*rastet e tyre (të B. S. dhe E. B.) janë kthyer prapë në rigjykim ndërsa mbetet vetëm rasti im që është refuzuar nga tri gjykatat*”. Parashtruesi i kërkesës për më tepër thekson se avokati i tij do duhej t'i kishte cekur këto fakte, marrë për bazë që avokati njëjtë kishte përfaqësuar B. S., E. B. dhe parashtruesin e kërkesës.
53. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës kishte bashkëngjitur vendime të gjykatave të rregullta, përkatësisht 2 (dy) aktvendime të Gjykatës së Apelit të 15 gushtit 2017, të cilat kanë prishur aktgjykimet e Gjykatës Themelore (për B. S. dhe E. B.) dhe kanë kthyer lëndën e tyre në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe kishte bashkëngjitur faqen e parë të 2 (dy) aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të nxjerra më 30 janar 2018 në të cilat shihet që kërkesëpaditë (e B. S. dhe E. B.) ishin aprovuar si të bazuara dhe ishte anuluar vendimi i punëdhënësit si jologjor.
54. Për më tepër, nga përgjigja e 26 nëntorit 2018 e Gjykatës Themelore, Gjykata vëren se këto lëndë janë në procedurë të ankesës, prandaj Gjykata nuk do t'i marrë parasysh ato vendime për dy arsye: (i) nuk ka vendime të plotfuqishme lidhur me ato raste (ii) parashtruesi i kërkesës vetëm ka bashkëngjitur këto pjesë të vendimeve të gjykatave të rregullta, por nuk ka sqaruar apo argumentuar se si rastet e bashkëngjitura janë të ngjashme apo si krahasohen me rastin e tij.
55. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me çka do të duhej apo nuk do të duhej të kishte përmendur avokati gjatë procedurave pranë gjykatave të

rregullta, Gjykata rikujton gjithashtu që pranë kësaj Gjykate, parashtruesi mund të ankohet vetëm për “shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë”.

56. Marrë për bazë rastin konkret, Gjykata rikujton dhe praktikën e GJEDNJ-së e cila ka përcaktuar që një avokat, edhe nëse ai ose ajo është emëruar zyrtarisht në një rast, nuk mund të konsiderohet si një organ i një shteti. Kjo vijon nga pavarësia e profesionit ligjor nga shteti, që sjellja e mbrojtjes është në thelb një çështje ndërmjet të pandehurit dhe avokatit të tij, qoftë nëse avokati emërohet në bazë të skemës së ndihmës juridike ose financohet privatisht dhe si i tillë nuk mundet, përveçse në rrethana të veçanta, të shkaktojë përgjegjësinë e Shtetit sipas Konventës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Krzysztof Tuziński kundër Polonisë*, nr. 40140/98, Vendim i 30 marsit 1999).
57. Gjykata më tej thekson, se sjellja në gjykatë e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi është përgjegjësi e parashtruesit. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet në parim parashtruesit të kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, Nr. 14102/02 Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/16, parashtrues *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2017, paragrafi 48).
58. Në fund, sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë (përkatësisht të neneve: 21 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 7 të DUDNJ-së.), Gjykata i gjen këto pretendime të pabazuara, sepse parashtruesi i kërkesës vetëm ka cituar këto nene të Kushtetutës dhe nuk ka ofruar asnjë argument ose provë me të cilën do t'i kishte mbështetur dhe justifikuar këto shkelje të pretenduara.
59. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ apo DUDNJ (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2013).
60. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

